

### Përmbledhje

Bazuar në vlerësimet e ASK-së, BPV-ja reale deri në shtator të vitit 2020 shënoi rënie prej -5.6 përqind. Me rënie janë karakterizuar investimet dhe eksportet neto ndërsa konsumi ka shënuar rritje. TM4 2020 vlerësohet se ka shënuar rënie të ngadalësuar krahasuar me tremujorët paraprak. Këto vlerësime mbështeten në rritjen e eksportit të mallrave dhe shërbimeve në periudhën raportuese, rritjen e konsumit publik, rritjen e remitencave, etj. Në anën tjetër, investimet publike, qarkullimi i bizneseve, kreditë e reja investuese shënuan rënie të konsiderueshme.

Në baza tremujore, asetet e sistemit financiar u rritën për 236.8 milionë euro, që përbën një rritje më të ngadalshme vjetore prej 6.6 përqind. Ecuritë në asetet e sistemit financiar kryesisht i atribuohen aktivitetit të sektorit bankar dhe sektorit të sigurimeve. Rritja e theksuar e aseteve të sektorit bankar në këtë tremujor reflekton kryesisht aktivitetin në depozita, të cilat u rritën si rrjedhojë e transferimit të mjeteve nga sektori pensional (tërheqja e parakohshme e 10 përqind të kursimeve nga kontribuuesit) në llogari të qytetarëve, si dhe rritjes të nivelit të depozitave prej korporatave jofinanciare.

Në kuadër të sektorit bankar, paraaja e gatshme dhe bilanci me BQK-në shënoi rritjen më të lartë, pasuar nga aktiviteti kreditues dhe investimet në letrat me vlerë. Kurse, në kuadër të detyrimeve, depozitat, si burimi kryesor i financimit të aktivitetit bankar, shënuan rritjen më të theksuar në këtë tremujor. Me rritje u karakterizuan edhe kategoria e burimeve vetanake (nga fitimi i mbajtur dhe i realizuar). Sektori bankar vazhdon të jetë mirë i kapitalizuar, likuid dhe me cilësi të lartë të portfolios kreditore.

Sektori pensional u karakterizua me tkurrje të aseteve në TM4 2020 si rezultat i tërheqjes së 10 përqind të kursimeve pensionale nga kontribuuesit në fund të vitit, e që u neutralizua deri në një masë nga kontributet e arkëtuara dhe kthimi pozitiv në investime.

Sektori i sigurimeve gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020 u karakterizua me rritje të aseteve, nivel më të lartë të primeve të shkruara dhe ulje të nivelit të dëmeve të paguara krahasuar me TM4 2019.

Sektori mikrofinanciar ka shënuar tkurrje të aktivitetit kundrejt vitit paraprak. Cilësia e portfolios kreditore vazhdon të jetë e lartë, por me tendencë rënie si rezultat i rritjes së rrezikut kreditor. Të nxitur nga pandemia Covid-19.

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020, Qeveria e Kosovës emetoi borxh në vlerë dukshëm më të lartë se në tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar. Rritja e nivelit të borxhit sovran reflekton rrethanat pandemike që ndikuan në rënien e të hyrave fiskale dhe njëkohësisht rritjen e shpenzimeve për mbështetje të ekonomisë.

## PËRMBAJTJA

<b>Përmbledhje</b> -----	<b>i</b>
<b>Zhvillimet Makroekonomike</b> -----	<b>4</b>
<b>Sistemi Financiar</b> -----	<b>5</b>
Sektori Bankar -----	5
Asetet -----	6
Performanca e sektorit bankar -----	11
<b>Kutia 1. Indeksi i Stabilitetit të Sektorit Bankar</b> -----	<b>13</b>
Sektori pensional -----	16
Sektori i sigurimeve -----	17
Performanca e sektorit të sigurimeve -----	18
Sektori mikrofinanciar -----	19
Asetet -----	19
Performanca e sektorit mikrofinanciar-----	21
Tregu i letrave me vlerë-----	22

## GRAFIKËT DHE TABELAT

Grafik 1. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës-----	05
Grafik 2. Ndryshimi tremujor në asete të sektorëve përbërës të sistemit financiar -----	05
Grafik 3. Struktura e aseteve të sektorit bankar në tremujorët përkatës -----	06
Grafik 4. Ndryshimi tremujor në stokun e kredive-----	06
Grafik 5. Struktura e kredive sipas veprimtarie ekonomike-----	07
Grafik 6. Kreditë e reja për korporatat jo financiare dhe ekonomitë familjare-----	07
Grafik 7. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake-----	08
Grafik 8. Depozitat sipas burimeve -----	08
Grafik 9. Struktura e depozitave sipas kategorive kryesore -----	09
Grafik 9A. Depozitat e reja të arkëtuara -----	09
Grafik 10. Norma e interesit në kredi dhe depozita-----	09
Grafik 11. Norma e interesit në kreditë ndaj korporatave -----	10
Grafik 12. Norma e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare -----	10
Grafik 13. Norma e interesit në depozita -----	10

Grafik 14. Norma e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare	11
Grafik 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare	11
Grafik 16. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar	11
Grafik 17. Kreditë joperformuese dhe mbulueshmëria me provizione	12
Grafik 18. Treguesit e solvencës	12
Grafik 19. Treguesit e likuiditetit	12
Grafik 20. Asetet e sektorit pensional	16
Grafik 21. Struktura e asetëve të FKPK-së	16
Grafik 22. Struktura e asetëve të FSKP-së	17
Grafik 23. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së	17
Grafik 24. Asetet e sektorit të sigurimeve	18
Grafik 25. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara	18
Grafik 26. Asetet e sektorit mikrofinanciar	19
Grafik 27. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare	19
Grafik 28. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë	20
Grafik 29. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar	20
Grafik 30. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar	21
Grafik 31. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik	21
Grafik 32. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar	21
Grafik 33. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar	22
Grafik 34. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore	22
Grafik 35. Shuma e borxhit të emetuar	23
Grafik 36. Shuma e ofruar dhe e emetuar	23
Grafik 37. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë	23
Tabela 1. Treguesit e zgjedhur makroekonomik	25

## **Zhvillimet Makroekonomike<sup>1</sup>**

Bazuar në vlerësimet e ASK-së, BPV-ja reale deri në shtator të vitit 2020 shënoi rënie prej -5.6 përqind. Me rënie janë karakterizuar investimet dhe eksportet neto ndërsa konsumi ka shënuar rritje. TM4 2020 vlerësohet se ka shënuar rënie të ngadalësuar krahasuar me tremujorët paraprak. Këto vlerësime mbështeten në rritjen e eksportit të mallrave dhe shërbimeve në periudhën raportuese, rritjen e konsumit publik, rritjen e remitencave, etj. Në anën tjetër, investimet publike, qarkullimi i bizneseve, kreditë e reja investuese shënuan rënie të konsiderueshme.

Çmimet e konsumit shënuan rënie prej -0.1 përqind në TM4 2020, kryesisht si pasojë e rënies së çmimeve të transportit, veshmbathjes, rekreacionit, orendive shtëpiake, etj. Rritje të ngadalësuar të çmimeve kanë shënuar edhe çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike, duke bërë që deflacioni bazë të jetë 0.8 përqind.

Zbutja e efektet negative në ekonomi të pandemisë Covid-19, ka ndikuar në përmirësimin e performancës së të hyrave buxhetore krahasuar me tremujorët paraprak. Të hyrat buxhetore në TM4 2020 shënuan rënie prej -0.6 përqind (-13.5 përqind në TM3 2020), ndërsa shpenzimet buxhetore shënuan rritje prej 8.6 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 280.5 milionë euro. Borxhi publik ka arritur në 1.5 miliardë euro, që është për 23.9

përqind më i lartë krahasuar me TM4 2019. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 21.8 përqind nga 17.5 përqind sa ishte në TM4 2019.

Sektori i jashtëm është karakterizuar me zvogëlim të deficit të llogarisë rrjedhëse prej 56.8 përqind në TM4 2020. Bilanci pozitiv i shërbimeve si dhe të ardhurat parësore dhe dytësore kanë shënuar rritje të konsiderueshme, ndërsa deficit i mallrave është përmirësuar. Deficiti tregtar i mallrave ishte 836.2 milionë euro apo 2.0 përqind më i ulët krahasuar me TM4 2019. Kjo rënie e deficitit të mallrave i atribuohet kryesisht rritjes së konsiderueshme të eksportit ndërkohë që edhe importi i mallrave shënoi rritje por jo në masën e eksportit. Në kuadër të bilancit të pagesave, remitencat shënuan rritje prej 26.3 përqind në TM4 2020.

---


<sup>1</sup> Për më shumë informata rreth zhvillimeve makroekonomike referojuni publikimit: Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike (TM4 2020) i publikuar në faqen e internetit të BQK-së.

## Sistemi Financiar

*Asetet e sistemit financiar në fund të dhjetorit 2020 arritën vlerën në 7.91 miliardë euro. Krahasuar me vitin e kaluar, sistemi financiar në vend është zgjeruar me ritëm më të ngadalësuar (grafik 1), kryesisht ndikuar nga zhvillimet në sektorin pensional. Tërheqja e 10 përqind të kursimeve pensionale nga kontributëdhënësit<sup>2</sup> në muajin dhjetor; si dhe kthimi më i ulët në investime gjatë vitit kanë ndikuar në ecurinë e sektorit pensional.*

Sektori bankar kishte kontributin kryesor në rritjen e aseteve të sistemit financiar, duke shënuar rritje vjetore prej 12.4 përqind në vitin 2020 (13.7 përqind në periudhën paraprake). Sektori i sigurimeve dhe ai mikrofinanciarë, kishin kontribut pozitiv në rritje, por ndikimi i tyre mbetet i ulët për shkak të peshës së ulët në gjithsej asetet e sektorit.

Grafik 1. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës




Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur  
Burimi: BQK (2021)

Kurse, në baza tremujore, asetet e sistemit financiar u rritën për 236.8 milionë euro, kryesisht ndikuar nga aktiviteti i sektorit bankar (+317.1 milionë euro) dhe

sektorit të sigurimeve (+6.2 milionë euro). Sektori pensional u tkurr për 78.9 milionë euro, përdërisa ai mikrofinanciar për 7.7 milionë euro.

Rritja e theksuar e aseteve të sektorit bankar në këtë tremujor reflekton kryesisht aktivitetin në depozita, të cilat u rritën si rrjedhojë e transferimit të mjeteve të trustit (10 përqindëshit) në llogari të qytetarëve, si dhe rritjes të nivelit të depozitave nga korporatat jofinanciare. Sektori pensional shënoi tkurrje në asete nga tërheqja e kursimeve pensionale të qytetarëve, e cila u neutralizua deri në një masë nga kthimi pozitiv në investime gjatë kësaj periudhe.

Grafik 2. Ndryshimi tremujor në asete të sektorëve përbërës të sistemit financiar




## Sektori Bankar

*Në kuadër të aseteve të sektorit bankar, paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në shënoi rritjen më të lartë, pasuar nga aktiviteti kreditues dhe investimet në letrat me vlerë. Kurse, në kuadër të detyrimeve, depozitat, si burimi kryesor i financimit të aktivitetit bankar, shënuan rritjen më të theksuar në këtë tremujor. Me rritje u karakterizua edhe kategoria e burimeve*

<sup>2</sup> Ligji 07/L-016 për rimëkëmbje ekonomike – Covid-19

*vetanake (nga fitimi i mbajtur dhe i realizuar).  
Sektori bankar vazhdon të jetë mirë i kapitalizuar, likuid dhe me cilësi të lartë të portfolios kreditore.*

Grafik 3. Struktura e aseteve të sektorit bankar në trejmuorët përkatës



## Asetet


Vlera e gjithsej aseteve të sektorit bankar në fund të TM4 2020 arriti në 5.35 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 12.4 përqind. Në baza tremujore, asetet e sektorit bankar u rritën për 317.1 milionë euro gjatë TM4 2020. Aktiviteti kreditues i sektorit bankar (që zë peshën më të madhe në kuadër të aseteve të sektorit me pjesëmarrje prej 60.6 përqind) ka shënuar rritje për 63.9 milionë euro në këtë tremujor, 10.8 milionë më pak se një vit më parë (grafik 3). Kategoria e bilancit me bankat komerciale, që janë kryesisht depozita dhe të ngjashme të investuara në bankat jashtë vendit, shënoi rritje për 43.0 milionë euro. Kategoria e investimeve në letrat me vlerë ka shënuar rritje për 52.3 milionë euro në këtë tremujor, duke ruajtur pothuajse nivelin e rritjes së vitit të kaluar. Përderisa, kategoria e parasë së mbajtur në trezor dhe në BQK shënoi rritjen më të theksuar, për 153.5

milionë euro në këtë tremujor, e që reflekton rritjen e theksuar të depozitave në fund të vitit 2020 (kryesisht transferimit të mjeteve të trustit në llogari të qytetarëve në kuadër të ligjit për rimëkëmbje ekonomike).

## Kreditë

Vlera e gjithsej kredive aktive në fund të TM4 2020 arriti në 3.25 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 7.1 përqind (rritje prej 10.0 përqind në fund të TM4 2019). Për herë të parë në pesë vitet e fundit, aktiviteti kreditues u karakterizua me ngadalësim të dinamikës së rritjes nga rritja dyshifrore në njëshifrore, e cila u ndikua nga kriza e shkaktuar nga gjendja pandemike. Kreditë ndaj korporatave jofinanciare, me pjesëmarrje 63.3 përqind në gjithsej kreditë, ngadalësuan rritjen në 7.2 përqind nga 9.8 përqind në periudhën në fund të dhjetorit 2019. Ngjashëm, kreditë ndaj ekonomive familjare ngadalësuan ritmin e rritjes vjetore në 7.1 përqind nga 10.4 përqind një vit më parë

Grafik 4. Ndryshimi tremujor në stokun e kredive




Vetëm gjatë TM4 2020 kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje për 20.4 milionë euro (24.2 milionë euro gjatë TM4 2019), përderisa kreditë ndaj

korporatave jofinanciare u rritën për 42.4 milionë euro (52.0 milionë euro gjatë TM4 2019) (grafik 4).


Në aspekt të veprimtarive ekonomike, në baza tremujore, vetëm kreditimi ndaj sektorit të bujqësisë dhe prodhimit shënuan rënie vjetore. Me rritje më të theksuar të kreditimit në këtë tremujor u karakterizuan sektori i tregtisë, ndërtimit dhe shërbimeve financiare (grafik 5).

Grafik 5. Ndryshimi tremujor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare, sipas veprimtarisë ekonomike



Kreditë e reja në TM4 2020 shënuan vlerën prej 391.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 5.7 përqind krahasuar me TM4 2019. Kreditë e reja ndaj korporatave jofinanciare u rritën për 1.1 përqind dhe shënuan vlerën prej 243.0 milionë euro në TM4 2020 (grafik 6). Rritje të theksuar shënuan kreditë për qëllime joinvestuese, prej 34.7 përqind, vlera e të cilave arriti në 122.8 milionë euro në këtë tremujor. Kurse, kreditë e reja për qëllime investuese u karakterizuan me rënie vjetore prej 21.0 përqind, duke zbritur në 113.9 milionë euro në TM4 2020. Në aspekt sektorial, kreditë e reja ndaj sektorit të shërbimeve u rritën, ndërsa sektorët tjerë u karakterizuan me rënie krahasuar me TM4 2019 (bujqësisë, industrisë dhe sektorëve tjerë).

Grafik 6. Kreditë e reja për korporatat jo financiare dhe ekonomitë familjare në TM4



Burimi: BQK (2021)


Ndërsa, me rritje të theksuar u karakterizuan kreditë e reja ndaj ekonomive familjare. Vlera e gjithsej kredive të reja ishte për 18.7 milionë euro më e lartë kundrejt TM4 2019, duke shënuar vlerën prej 148.3 milionë euro në TM4 2020. Prej tyre, kreditë e reja për qëllim konsumi shënuan rritjen prej 10.5 përqind, dhe arritën vlerën në 98.4 milionë euro gjatë TM4 2020. Me rritje më të theksuar, prej 44.3 përqind u karakterizuan kreditë e reja hipotekare, që shënuan vlerën në 39.8 milionë euro gjatë TM4 2020.

Dinamikat e evidentuara në kreditë e reja të lëshuara gjatë tremujorit të katërt dhe tremujorëve paraprak të vitit 2020 reflektojnë edhe kreditë e riprogramuara nga sektori bankar. Gjatë kësaj periudhe, BQK mundësoi ristrukturimin e kredive si masë lehtësuese për klientët/kredimarrësit e prekur nga kriza e shkaktuar nga pandemia Covid-19. Si rrjedhojë, gjatë periudhës mars-dhjetor 2020, në mesatare, rreth 38.0 përqind e total stokut të kredive ishin kredi të riprogramuara kurse niveli i tyre historikisht kishte një mesatare prej 1.0 përqind.

## Detyrimet dhe burimet vetanake

Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake përbëhet kryesisht prej depozitave (81.4 përqind), stoku i të cilave në fund të muajit dhjetor 2020 arriti në 4.36 miliardë euro dhe shënoi një rritje vjetore prej 11.5 përqind (16.2 përqind në dhjetor 2019). Kurse, në baza tremujore, depozitat shënuan rritje të përshpejtuar krahasuar me TM4 2019 (grafik 7). Kategoria e burimeve vetanake të sektorit u rrit për 22.0 milionë euro në TM4 2020 (për 5.8 milionë euro në TM4 2019), si rrjedhojë e fitimit të realizuar në këtë periudhë dhe fitimit të pashpërndarë në këtë periudhë. Në fund të muajit dhjetor 2020, stoku i gjithsej ekuitetit arriti vlerën prej 611.0 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 17.5 përqind.

Grafik 7. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake, ndryshimi tremujor




## Depozitat

Rritja dyshifrore e stokut të depozitave krahasuar me vitin paraprak, përkundër efekteve negative të shkaktuara nga pandemia Covid-19, ishte kryesisht si rezultat i transferimit të 10 përqind të mjeteve të pensioneve në llogari të kontributdhënësve, si dhe rritjes së depozitave prej korporatave jofinanciare. Tërheqja e depozitave prej llogarive të pensioneve u

reflektua në rritjen e depozitave në sektorin bankar në TM4 2020.

Grafik 8. Depozitat sipas burimeve, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK (2021)


Në këtë periudhë, depozitat u rritën për 303.4 milionë euro, kundrejt rritjes prej 172.5 milionë euro në TM4 2019. Depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje për 234.1 milionë euro në TM4 2020 dhe arritën vlerën prej 2.94 miliardë euro në fund të periudhës (dhjetor 2020) (grafik 8). Kurse, depozitat e korporatave jofinanciare në këtë tremujor u rritën për 113.4 milionë euro dhe arritën vlerën prej 825.7 milionë euro në fund të periudhës (dhjetor 2020). Depozitat prej korporatave tjera financiare në këtë tremujor shënuan rënie për 53.8 milionë euro (+22.8 milionë euro në TM4 2019), e që reflekton kryesisht zhvillimet në sektorin pensional. Në fund të periudhës, stoku i kësaj kategorie shënoi vlerën prej 263.3 milionë euro. Sipas kategorive të depozitave, depozitat e transferueshme u zgjeruan në vlerë prej 295.2 milionë euro (+133.0 milionë euro në TM4 2019) në baza tremujore, kurse stoku i tyre arriti vlerën prej 2.79 miliardë euro në fund të periudhës (dhjetor 2020) (grafik 9).

Ndërsa, depozitat e afatizuara gjatë kësaj periudhe u tkurrën për 19.4 milionë euro (zgjerim për 28.8 milionë euro gjatë TM4 2019), duke arritur vlerën prej 1.02



miliardë euro në fund të periudhës (dhjetor 2020).


Grafik 9. Struktura e depozitave sipas kategorive kryesore, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK (2021)

Depozitat e kursimeve gjatë këtij tremujori u zgjeruan për 27.6 milionë euro (+10.6 milionë euro gjatë TM4 2019), duke arritur vlerën prej 552.7 milionë euro në fund të periudhës (dhjetor 2020).

Grafik 9-A. Depozitat e reja të arkëtuara, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK (2021)

Depozitat e transferueshme vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej depozitat e sektorit (64.0 përqind), pasuar nga depozitat e afatizuara (23.4 përqind) dhe të kursimit (12.7 përqind).


Vlera e depozitave të reja të arkëtuara<sup>3</sup> në TM4 2020 ishte 142.8 milionë euro, prej të cilave 54.0 milionë

euro ishin depozita të arkëtuara nga korporatat jofinanciare, ndërsa 88.7 milionë euro depozita të arkëtuara nga ekonomitë familjare (grafik 9A).

## Normat e Interesit<sup>4</sup>

Norma mesatare e interesit në kredi në TM4 2020 ishte 6.1 përqind, apo 0.3 pikë përqindje më e ulët kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Ndërsa, norma mesatare e interesit në depozita mbeti në nivel të përafërt me periudhën paraprake, në 1.6 përqind në TM4 2020. Rrjedhimisht, margjina në mes të normës së interesit në kredi dhe asaj në depozita qëndroi në 4.5 pikë përqindje (grafik 10).

Grafik 10. Norma e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK (2021)

## Normat e interesit në kredi

Norma mesatare e interesit në kreditë për korporatat jofinanciare qëndroi në 6.0 përqind gjatë TM4 2020, apo për 0.2 pikë përqindje më e ulët se në vitin paraprak (grafik 11).


Në bazë të kategorive të kredive, norma e interesit për kreditë investive ishte më e ulët (6.0 përqind) krahasuar me normën e interesit për kreditë jo-investive (6.2 përqind). Krahas periudhës së njëjtë të

<sup>3</sup> Depozita e reja përfshijnë depozitat e afatizuara

<sup>4</sup> Kalkulimi i normave të interesit: mesatarja tremujore e normave të interesit në kredi, gjegjësisht në depozita. Në tekst ju referohemi si 'normë e interesit'.

vitit paraprak, vërehet rënie më e theksuar në normën e interesit për kreditë jo-investive (për 0.21 pikë përqindje) krahasuar me rënien për kreditë investive (për 0.1 pikë përqindje).

**Figura 11. Normat e interesit në kreditë ndaj korporatave jofinanciare**




Burimi: BQK (2021)

Në aspekt sektorial, norma e interesit në kreditë bujqësore shënoi rënie për 0.9 pikë përqindje, duke zbritur në mesataren prej 6.2 përqind.

Ngjashëm, edhe normat e interesit në kreditë industriale dhe shërbyese shënuan rënie për 0.3 përkatësisht 0.2 pikë përqindje, në 5.9 përkatësisht 6.1 përqind.

**Grafik 12. Normat e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare**



Burimi: BQK (2021)


Tek ekonomitë familjare, norma mesatare e interesit në kredi qëndroi në 6.3 përqind, që paraqet një rënie për 0.5 pikë përqindje krahasuar me TM4 2019. Norma

më e lartë e interesit ishte për kreditë konsumuese (6.6 përqind), që shënoi rënie për 0.5 pikë përqindje krahasuar me TM4 2019. Për më shumë, edhe norma e interesit në kreditë hipotekare shënoi rënie gjatë këtij tremujori (prej 5.5 përqind në TM4 2019 në 5.3 përqind në TM4 2020) (grafik 12).

**Normat e interesit në depozita**

Norma mesatare e interesit në depozita qëndroi në nivel të përafërt me periudhën paraprake, në 1.6 përqind (grafik 13).

**Grafik 13. Norma e interesit në depozita**




Burimi: BQK (2021)

Normat e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare vazhdojnë të jenë më të favorshme krahasuar me ato për ekonomitë familjare, edhe pse dallimi mes tyre është marxhinal.

Norma e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare ishte e përafërt me vitin e kaluar, në 1.8 përqind (grafik 14).

Ngjashëm, edhe normat e interesit në depozitat e ekonomive familjare mbetën të përafërta në këtë tremujor krahasuar me periudhën paraprake (TM4 2019).


Grafik 14. Norma e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare, sipas kategorive



Burimi: BQK (2021)

Norma mesatare e interesit qëndroi në 1.4 përqind, ngjashëm me normën për depozitat e afatizuara, kurse ato të kursimit në 0.4 përqind (grafik 15).

Grafik 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare, sipas kategorive



Burimi: BQK (2021)


### Performanca e sektorit bankar

Sektori bankar në TM4 2020 realizoi profit në vlerë prej 22.7 milionë euro, e që është për 2.1 milionë euro më i lartë krahasuar me TM4 2019 (grafik 16). Fitimi më i lartë i realizuar në TM4 2020 ishte kryesisht rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave (për 6.6 milionë euro) krahasuar me rritjen e shpenzimeve (për 4.5 milionë euro). Të hyrat gjatë këtij tremujori arritën vlerën në 71.8 milionë euro, ku të hyrat nga interesi

(kryesisht të hyra nga interesi në kredi) arritën vlerën prej 47.6 milionë euro (rënie vjetore për 1.4 milionë euro). Kurse të hyrat nga jointerеси, të cilat kryesisht janë të hyra nga tarifat dhe komisionet, shënuan vlerën prej 18.8 milionë euro, një rritje vjetore për 5.4 milionë euro krahasuar me TM4 2019.

Shpenzimet e sektorit bankar shënuan vlerën prej 49.2 milionë euro në TM4 2020. Kategoria më e madhe, ajo e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, shënuan vlerën prej 28.2 milionë euro, e përafërt me TM4 2019. Kategoria e shpenzimeve të jointerесit në TM4 2020 arriti në vlerën 15.3 milionë euro (për 8.7 milionë më shumë se në periudhën paraprake), kryesisht si rrjedhojë e ndarjes më të lartë të shpenzimeve për provizionet për humbjet e mundshme në kredi, e ndikuar nga rritja e rrezikut kreditor nga kriza e shkaktuar nga situata pandemike. Kurse, kategoria e shpenzimeve të interesit gjatë kësaj periudhe u zvogëlua për 3.4 milionë euro, duke qëndruar në 3.1 milionë euro në TM4 2020.

Grafik 16. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK (2021)


Ritmi i rritjes së të hyrave (10.2 përqind) dhe shpenzimeve (10.2 përqind), ndikoi që raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të qëndroj në nivel të

pandryshuar me TM4 2019, prej 68.4 përqind. Ky raport nënkupton që për çdo 1 euro të arkëtuar, sektori bankar shpenzon 0.684 euro (grafik 16).

### Treguesit e shëndetit financiar

Treguesit e shëndetit financiar të sektorit bankar vazhduan të jenë në nivel të lartë gjatë TM4 2020, duke tejkaluar minimumet e kërkuara me rregullore.

**Grafik 17. Kredite joperformuese dhe mbulueshmëria me provizione**




Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur  
 Burimi: BQK (2020)

Kreditë joperformuese, edhe pse kanë shënuar rritje krahasuar me tremujorët paraprak, niveli i tyre ndaj gjithsej kredive vazhdon të jetë i ulët. Norma e kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në dhjetor 2020 qëndroi në nivel prej 2.7 përqind (2.0 përqind në fund të dhjetorit 2019) (grafik 17). Kreditë joperformuese vazhdojnë të jenë mirë të provizionuara, në shkallë prej 141.4 përqind (163.5 përqind në fund të dhjetorit 2019).

Sektori bankar vazhdon të jetë mirë i kapitalizuar dhe i qëndrueshëm si rrjedhojë e kapitalit të trashëguar nga vitet paraprake dhe fitimit të realizuar në vitin 2020. Gjatë kësaj periudhe, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte në nivel prej 16.5 përqind, nivel ky

më i lartë për 0.7 pikë përqindje se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 18).


**Grafik 18. Treguesi i solvencës**



Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur  
 Burimi: BQK (2021)

Rritja e këtij treguesi i atribuohet rritjes më të lartë të gjithsej kapitalit krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të mjeteve të peshuara me rrezik. Rritja më e theksuar e kapitalit është ndikuar dhe nga mosndarja e dividendës gjatë vitit 2020<sup>5</sup>. Kurse, rritja më e ngadalësuar e mjeteve të peshuara me rrezik reflekton ngadalësimin e rritjes së kreditimit krahasuar me vitin e kaluar.

**Grafik 19. Treguesit e likuiditetit**




Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur  
 Burimi: BQK (2021)

<sup>5</sup> Përjashtim bënë ndarja e dividendës në vlerë prej 3.7 milionë euro nga njëra bankë, mjete të cilat janë investuar në instrumente tjera të kapitalit jashtë sektorit bankar.

Sa i përket likuiditetit të sektorit bankar, raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra shënoi përmirësim të lehtë, për 2.3 pikë përqindje krahas gjendjes në fund të TM4 2019, në nivel prej 39.8 përqind. Rritja e këtij indikatorit erdhi si rezultat i rritjes më të përshpejtuar të mjeteve likuide (parasë së gatshme, bilanci me BQK dhe bilanci me bankat tjera) krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të detyrimeve afatshkurtra (kryesisht depozitave të transferueshme). Në fund të dhjetorit 2020, si rrjedhojë e rritjes më të lartë të depozitave krahasuar me ritmin e rritjes së kredive, raporti i kredive ndaj depozitave zbriti në 74.5 përqind nga 77.6 përqind në dhjetor 2019.

mbi treguesit financiar bazë të stabilitetit të sektorit bankar, duke marrë vlera në intervalin 0 deri 1, ku vlerat më të larta paraqesin rrezik në rënie dhe anasjelltas.<sup>6</sup> Indeksi është kalkuluar në baza tremujore për të vlerësuar nëse kemi rritje apo ulje të ndjeshmërisë së rrezikut përmes këtij indeksi.

Grafik 1. Indeksi i përgjithshëm i stabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK 2021

## **Kutia 1. Indeksi i Stabilitetit të Sektorit**

### **Bankar**

Sektorin bankar, para përhapjes së pandemisë Covid-19, ka operuar përgjithësisht në një ambient me nivel të ulët të rreziqeve. Përhapja e pandemisë Covid-19 që nga gjysma e dytë e muajit mars si dhe masat e vazhdueshme për parandalimin e saj, kanë ndikuar në rritjen e rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet sektori bankar. Në këtë kuti tentohet të paraqitet efekti i pandemisë Covid-19 në ecurinë e treguesëve me frekuencë të shpeshtë të sektorit bankar, të përmbledhura në Indeks të Stabilitetit të Sektorit Bankar.


Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar është ndërtuar me qëllim të matjes dhe vlerësimit të kushteve të brendshme të sektorit bankar që reflektojnë stabilitetin e sektorit bankar. Indeksi është i ndërtuar

Sipas indeksit të përgjithshëm të agreguar të stabilitetit të sektorit, në mesatare, është shënuar rritje e ndjeshmërisë ndaj rrezikut (lexo: rënie të indeksit) në TM4 2020 krahasuar me TM4 2019. Vlera e përgjithshme e indeksit, nëse krahasohet me tremujorët e njëjtë të viteve të kaluara, është në nivelin më të ulët (0.43) që nga TM4 2013 (grafik 1).

Krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, rënie të indeksit (lexo: rritje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut) shënuan: indikatorin e rrezikut kreditor, profitabilitetit dhe tregut. Ndërsa, rritje të indeksit (ulje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut) shënoi indikatorin e rrezikut të solvencës dhe likuiditetit. Vlen të theksohet që indikatorin që matë rrezikun e tregut, ka peshë mjaftë të ulët në indeksin e përgjithshëm, dhe rritja e këtij indikatorin nuk paraqet rrezik për sektorin bankar, si rrjedhojë e nivelit të ulët të mjeteve të mbajtura në valutë të huaj (grafik 2).

<sup>6</sup> Për më tepër rreth metodologjisë së ndërtimit të indeksit të stabilitetit të sektorit bankar, referojuni Raportit të Stabilitetit Financiar nr.9.


Grafik 2. Kriteret përbërëse të indeksit të stabilitetit të sektorit bankar



**Rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të solvencës** në fund të TM4 2020 krahasuar me gjendjen në fund të TM4 2019, i atribuohet rritjes së kapitalizimit të sektorit. Në rritje të nivelit të kapitalizimit ka ndikuar rritja më e shpejtë e kapitalit rregullativ kundrejt rritjes më të ngadalësuar të aseteve që bartin rrezik. Rritja e nivelit të kapitalit është rezultat i fitimit të pashpërndarë gjatë kësaj periudhe si dhe fitimit të realizuar deri në dhjetor të vitit 2020. Kurse, ngadalësimi i rritjes së aseteve që bartin rrezik është rezultat i ngadalësimit të rritjes së aktivitetit kreditues që nga fillimi i pandemisë krahasuar me trendin e viteve të fundit (rritje dyshifrore në tri vitet paraprake).


**Rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të likuiditetit** në TM4 2020 krahasuar me nivelin në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kryesisht i atribuohet rritjes më të lartë të mjeteve likuide krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të detyrimeve afatshkurtra. Paraja e gatshme dhe mjetet e mbajtura në BQK nga bankat komerciale shënuan rritje më të lartë krahasuar me muajin dhjetor të vitit të kaluar. Kjo rritje e mjeteve likuide ndër tjerash reflekton fillimin e tërheqjes së 10 përqind të pensioneve nga qytetarët në kuadër të pakos së rimëkëmbjes ekonomike në fund të dhjetorit 2020.

Grafik 3. Indikator i solvencës



Në anën tjetër, detyrimet afatshkurtra shënuan rritje më të ngadalësuar kundrejt mjeteve likuide, e që kryesisht janë depozita të cilat maturojnë brenda një vitit.


Grafik 4. Indikator i likuiditetit



**Rritja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut kreditor** erdhi si rezultat i rritjes së kredive joperformuese në vlerë absolute si dhe në raport me gjithsej kreditë. Trendi rënës i vlerës së kredive joperformuese u ndërpre për herë të parë në TM1 2020, që nga TM4 2014 kur filloi rënien, e që ndër tjerash u ndikua prej ndryshimit metodologjik me fillimin e implementimit të standardeve të SNRF 9. Niveli i KJP-ve pritet të rritet edhe në periudhat në vijim, i ndikuar edhe nga efekti pandemisë Covid-19 në ekonominë e Kosovës. Në rritjen e ndjeshmërisë ndaj rrezikut kreditor ndikoi edhe rritja e nivelit të ekspozimeve të mëdha kreditore ndaj kapitalit të klasit të parë krahasuar me periudhën paraprake (TM3 2019).

Rritja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të profitabilitetit, kryesisht mund t'i atribuohet nivelit më të lartë të shpenzimeve të ndodhura në vitin 2020, e që reflektojnë kryesisht rritjen e shpenzimeve për provizionimin e humbjeve të mundshme në kredi.


Grafik 5. Indikator i rrezikut kreditor



Burimi: BQK 2021


Të hyrat e sektorit shënuan rritje kundrejt vitit të kaluar, megjithatë nuk arritën të ruajnë nivelin e fitimeve të realizuara në vitin 2019. Rrjedhimisht, profiti më i ulët ka ndikuar në rënien e indikatorëve të profitabilitetit siç janë Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK), si dhe në raportin e shpenzimeve ndaj të hyrave.

Grafik 6. Indikator i profitabilitetit



Burimi: BQK 2021

Grafik 7. Indikator i rrezikut të tregut



Burimi: BQK 2021


Rritja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të tregut i'u atribuua kryesisht rritjes së pozicionit neto në valutë të huaj të sektorit bankar. Ky indikator ka peshën më të ulët në indeksin e përgjithshëm të stabilitetit financiar për shkak që rreth 5 përqind e aseteve dhe rreth 4 përqind e detyrimeve janë në valutë të huaj. Për më tepër, edhe niveli i kredive dhe depozitave në valutë të huaj është në nivel mjaftë të ulët. Si rrjedhojë, lëvizjet në këtë indikator kanë ndikim mjaftë të ulët në indeksin e agreguar të stabilitetit financiar.

## Sektori pensional

*Sektori pensional u karakterizua me tkurrje të aseteve në TM4 2020 si rezultat i tërheqjes së 10 përqindëshit të kursimeve pensionale në fund të vitit, e që u neutralizua deri në një masë nga kontributet e arkëtuara dhe kthimi pozitiv në investime.*

Sektori pensional, si sektori i dytë për nga pesha në sistemin financiar, përbën 25.3 përqind të gjithëj aseteve të sistemit financiar. Si rrjedhojë e tërheqjes së mjeteve nga kontributdhënësit në nivel prej 10 përqind, gjithëj asetet e sektorit pensional shënuan rritje vjetore prej vetëm 1.2 përqind në dhjetori 2020, duke arritur vlerën prej 2.0 miliardë euro. Në baza tremujore, vetëm gjatë TM4 2020, asetet e sektorit pensional u zvogëlua për 78.9 milionë euro (rritje prej 61.4 milionë euro në TM4 2019) (grafik 20).


Grafik 20. Asetet e sektorit pensional, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK (2021)

Asetet e sektorit pensional përbëhen 99.6 përqind nga asetet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) dhe 0.4 përqind nga asetet e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve (FSKP).

Grafik 21. Struktura e aseteve të FKPK-së (TM4 2020)




Burimi: FKPK (2021)

Struktura e aseteve e FKPK-së përbëhet kryesisht nga mjetet e investuara jashtë vendit, por që pesha e tyre krahasuar me periudhën paraprake shënoi rënie të konsiderueshme. Rreth 68.0 përqind e mjeteve të FKPK-së janë të mbajtura jashtë vendit, apo rreth 1.35 miliardë euro të alokuara në fonde të përbashkëta investuese (grafik 21). Pjesa e mbetur e mjeteve të investuara brenda vendit (32.0 përqind) janë rritur për 7.2 pikë përqindje kundrejt tremujorit të njëjtë të vitit paraprak. Deri në fund të dhjetorit 2020, vlera e investimeve brenda vendit arriti në 637.7 milionë euro. Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve janë të investuara në fletëobligacione dhe bono të thesarit të Qeverisë së Kosovës, të cilat vetëm gjatë TM4 2020 janë rritur për 18.5 milionë euro. Kategoria e mjeteve të deponuara në sektorin bankar është tkurrur për 54.5 milionë euro në këtë tremujor, e që ndër tjerash reflekton tërheqjen e 10 përqind të mjeteve të trustit nga kontributdhënësit. Përderisa, paraja e mbajtur në Bankën Qendrore të Kosovës ka shënuar rritje për 12.2 milionë euro gjatë TM4 2020.




Grafik 22. Struktura e aseteve të FSKP-së (TM4 2020)



Burimi: FSKP (2021)

Struktura e aseteve të FSKP-së përbëhet kryesisht nga aksionet e investuara jashtë vendit (64.4 përqind), obligacionet e qeverive të huaja dhe të Kosovës (22.8 përqind) dhe aseteve tjera (grafik 22). Gjithsej asetet e FSKP-së gjatë TM4 2020 u rritën për 352.9 mijë euro, prej të cilave pjesa më e madhe ishin investime në sektorin e brendshëm.

Grafik 23. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së



Burimi: FKPK (2021)

Gjatë TM2 dhe TM3 2020, FSKP rikuperoi në masë të madhe humbjet nga investimet të shënuara gjatë TM1 2020 (-910.0 mijë euro). Kurse deri në fund të dhjetorit 2020, sektori arriti të realizoj kthim bruto në investime në vlerë prej 388.8 mijë euro. Vetëm gjatë TM4 2020 sektori realizoi kthim bruto në investime në vlerë prej 449.8 mijë euro (269.0 mijë euro gjatë TM4 2019).

Ndërsa, vlera e arkëtimeve të reja nga kontributdhënësit gjatë TM4 2020 arriti në 162.0 mijë euro (153.0 mijë euro në TM4 2019).

Në këtë tremujor, kontributet e arkëtuara të FKPK-së u shtuan në vlerë prej 58.7 milionë euro, një rritje për 17.1 përqind krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Pas humbjeve të konsiderueshme që FKPK kishte nga investimet jashtë vendit në TM1 2020 (-90.4 milionë euro), tregjet financiare filluan rikuperimin dhe FKPK arriti të realizoj fitim rekord prej 70.3 milionë euro vetëm gjatë TM2 2020, 32.7 milionë euro në TM3 dhe 59.3 milionë euro në TM4. Andaj FKPK vitin 2020 e mbylli me rezultat të konsiderueshëm pozitiv, përkatësisht kthim bruto nga investimet në vlerë prej 71.9 milionë euro.


## Sektori i sigurimeve

*Sektori i sigurimeve gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020 u karakterizua me rritje të aseteve, nivel më të lartë të primeve të shkruara dhe rënie të nivelit të dëmeve të paguara krahasuar me TM4 2019.*

Asetet e sektorit të sigurimeve deri në fund të muajit dhjetor 2020 arritën në vlerën 220.5 milionë euro, e që paraqet rritje vjetore prej 12.2 përqind. Depozitat e mbajtura në bankat komerciale dhe investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës ishin zërat me rritjen më të lartë. Vetëm në TM4 2020, asetet e sektorit të sigurimeve u rritën për 6.2 milionë euro (grafik 24). Edhe në baza tremujore, rritja u reflektua kryesisht prej depozitave të mbajtura në bankat komerciale, pasuar nga investimeve në letrat me vlerë

të Qeverisë së Kosovës, huatë dhe të arkëtueshmet, si dhe kategoria e risiguruesit për rezervat teknike.

**Grafik 24. Asetet e sektorit të sigurimeve, ndryshimi tremujor**



Burimi: BQK (2021)

Ngjashëm me asetet, edhe niveli i përgjithshëm i kapitalizimit të sektorit u karakterizua me rritje. Vetëm gjatë këtij tremujori, gjithsej kapitali shënoi rritje prej 2.4 milionë euro, duke arritur vlerën prej 59.7 milionë euro në fund të periudhës (dhjetor 2020). Kjo rritje e kapitalit i'u atribuua shtimit të kapitalit aksionar të paguar dhe kategorisë së rezervave të rivlerësimit. Kurse, humbjet e realizuara dhe ato të mbajtura nga vitet e kaluara (me theks të veçantë në vitin 2016) pamundësuan rritjen e mëtejme të kapitalit të sektorit në këtë periudhë raportuese.

Detyrimet e sektorit shënuan gjithashtu rritje gjatë kësaj periudhe (+3.8 milionë euro), e që kryesisht janë rezerva teknike. Vlera e gjithsej detyrimeve në fund të dhjetorit 2020 arriti në 160.7 milionë euro.

Vlera e primeve të shkruara bruto në sektorin e sigurimeve në TM4 2020 arriti në 27.0 milionë euro, një rritje vjetore prej 7.0 përqind (9.7 përqind rritje vjetore gjatë TM4 2019) (grafik 25). Primet e kategorisë 'jo-jetë' përbëjnë 96.6 përqind të gjithsej primeve të shkruara, ndërsa ato të kategorisë 'jetë' 3.4 përqind.


Ngadalësimi i rritjes së primeve të shkruara deri në një masë reflekton efektet e pandemisë Covid-19 në ekonomi. Gjatë TM4 2020, numri i policave ('jo-jetë') të shitura ishte 256.8 mijë, krahasuar me 286.8 mijë në TM4 2019.

Vlera e dëmeve të paguara nga sektori i sigurimeve (përfshirë edhe Byronë Kosovare të Sigurimit) shënoi rënie gjatë TM4 2020 kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Në TM4 2020, dëmeve të paguara shënuan vlerën prej 14.5 milionë euro (17.2 milionë euro në TM4 2019) (grafik 25). Si rrjedhojë e rritjes së nivelit të primeve të shkruara kundrejt rënies së nivelit të dëmeve të paguara, raporti dëme/prime në TM4 2020 u përmirësua, duke u zvogëluar për 14.4 pikë përqindje, në 53.8 përqind (grafik 25).

### Performanca e sektorit të sigurimeve

Gjatë TM4 2020, sektori i sigurimeve performoi me humbje neto në vlerë prej 820.8 mijë euro (humbje në vlerë prej 4.5 milionë euro në TM4 2019).

**Grafik 25. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara**



Burimi: BQK (2021)

Reduktimi në masë të madhe i humbjeve të realizuara krahasuar me periudhën paraprake është rezultat i rënies së nivelit të dëmeve paguara dhe shpenzimeve

operative. Në anën tjetër, edhe rritja e nivelit të primeve të shkruara ka ndikuar në ulje të dukshme të rezultateve negative financiare krahasuar me periudhën paraprake.


## Sektori mikrofinanciar

*Sektori mikrofinanciar ka shënuar tkurrje të aktivitetit në TM4 2020 kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Megjithatë, performanca e sektorit shënoi rritje, si rezultat i rënies më të lartë të shpenzimeve krahas rënies së të ardhurave. Cilësia e portfolios kreditore mbetet e lartë, megjithëse me tendencë rënëse.*

## Asetet

Pas katër vitesh të zgjerimit të theksuar të aktivitetit, në dhjetor të këtij viti është shënuar ngadalësim i rritjes së institucioneve mikrofinanciare dhe financiare jobankare.

Grafik 26. Asetet e sektorit mikrofinanciar, ndryshimi tremujor




Burimi: BQK (2021)

Vlera e aseteve arriti në 316.2 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 2.1 përqind (23.9 përqind rritje vjetore në dhjetor 2019).

Në baza tremujore, asetet u tkurrën për 1.7 milionë euro gjatë TM4 2020 krahasuar me rritjen prej 9.4 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Tkurrja e aktivitetit të sektorit në TM4 2020 i'u atribuu kryesisht pasojave të shkaktuara nga pandemia Covid-19 në ekonominë e vendit, e cila u reflektua në rënie të nivelit të huazimeve të marra nga sektori i jashtëm. Aktiviteti kreditues u karakterizua me rënie, ndërsa lizingjet ngadalësuan dukshëm trendin e rritjes (grafik 26). Po ashtu, në tkurrje të aktivitetit të sektorit ka ndikuar edhe procesi i largimit prej zërave bilancor të dy institucioneve të cilave i'u është revokuar licenca në fund të vitit 2019.

Grafik 27. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare, ndryshimi vjetor i kredive



Burimi: BQK (2021)

## Kreditë


Në baza vjetore, gjithsej kreditë shënuan rënie për 6.8 përqind në fund të muajit dhjetor 2020, përderisa stoku i tyre zbriti në 205.0 milionë euro. Krahasuar me periudhën paraprake, kreditë shënuan tkurrje të theksuar tek të dy kategoritë: korporatat jofinanciare dhe ekonomive familjare. Kreditimi ndaj ekonomive familjare shënoi rënie prej 9.2 përqind (21.9 përqind rritje vjetore deri në dhjetor 2019), duke zvogëluar vlerën në 134.4 milionë euro në fund të dhjetorit 2020.

Vlera e gjithsej kredive, në baza tremujore, u zvogëlua për 0.5 milionë euro gjatë TM4 2020, krahasuar me rritjen për 5.4 milionë euro gjatë TM4 2019. Vetëm gjatë TM4 2020, kreditë ndaj ekonomive familjare u zvogëluan për 1.4 milionë euro (grafik 27).

Stoku i kredive ndaj korporatave jofinanciare në fund të dhjetorit 2020 zbriti në vlerë prej 70.6 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 1.9 përqind (rritje vjetore prej 15.3 përqind deri në dhjetor 2019). Në baza tremujore, gjatë TM4 2020, kreditë ndaj korporatave jofinanciare u rritën për 0.8 milionë euro.

Në aspekt sektorial, në baza tremujore, kreditimi ndaj sektorit të bujqësisë dhe shërbimeve tjera shënuan rritje, edhe pse në nivel më të ulët se në periudhën paraprake. Kurse, kreditimi ndaj sektorit të ndërtimtarisë dhe tregtisë u karakterizuan me rënie gjatë TM4 2020 (grafik 28).

**Grafik 28. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë, ndryshimi tremujor**




Burimi: BQK (2021)

### Lizingjet

Për dallim nga zhvillimet në kreditim, institucionet mikrofinanciare ruajtën deri në një masë trendin e rritjes së aktivitetit të lizingjeve gjatë kësaj periudhe. Aktiviteti i lizingut në sektorin mikrofinanciar shënoi rritje në vlerë prej 0.6 milionë euro gjatë TM4 2020 (4.3

milionë euro në TM4 2019), dhe arriti vlerën prej 57.3 milionë euro në fund të periudhës. Kjo rritje kryesisht reflekton lizingun ndaj korporatave jofinanciare, vlera e të cilit u shtua gjatë këtij tremujori për 0.4 milionë euro dhe arriti në 31.4 milionë euro në fund të periudhës (grafik 29).

**Grafik 29. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar**



Burimi: BQK (2021)


Njëkohësisht, edhe lizingu ndaj ekonomive familjare u shtua për 0.2 milionë euro në TM4 2020, duke rritur vlerën e përgjithshme në 25.9 milionë euro në fund të periudhës së cekur.

### Normat e Interesit

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020, norma mesatare e interesit në kredi qëndroi në 20.0 përqind, apo për 0.3 pikë përqindje më e ulët se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 30).

Tek ekonomitë familjare, norma e interesit shënoi rritje marginale, për 0.4 pikë përqindje, në 21.4 përqind gjatë TM4 2020 (grafik 30). Sipas kategorive të kredive, tek kreditë hipotekare, norma mesatare e interesit u zvogëlua për 2.5 pikë përqindje në 18.4 përqind në TM4 2020. Kurse, tek kreditë konsumuese, kishte rritje për 0.9 pikë përqindje, në 22.1 përqind.


Grafik 30. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2021)

Për dallim nga ekonomitë familjare, tek korporatat jo financiare, norma mesatare e interesit në kredi u zvogëluar lehtësisht, për 0.6 pikë përqindje, në 18.0 përqind. Në aspekt sektorial, normë më të favorshme të interesit kishin kreditë e orientuara për industrinë, pasuar nga shërbimet dhe bujqësinë. Norma mesatare tremujore e interesit për kreditë e bujqësisë dhe industrisë shënoi rënie vjetore për 1.9, përkatësisht 0.7 pikë përqindje. Kurse, rritje shënuan normat e interesit për kreditë ndaj sektorit të shërbimeve, të cilat historikisht kishin kushtet më të favorshme për të marrë kredi, duke arritur në 20.0 përqind gjatë TM4 2020 (rritje për 4.7 pikë përqindje krahasuar me TM4 2019) (grafik 31).

Grafik 31. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2021)

## Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektor i mikrofinanciar në vitin 2020 shënoi fitim në vlerë prej 0.3 milionë euro, e që është dukshëm më i ulët se ai prej 9.3 milionë euro në vitin paraprak. Kjo rënie ishte si rezultat i rënies më të përshpejtuar të shpenzimeve kundrejt rënies së të hyrave. Kurse, sa i përket performancës tremujore, në TM4 2020 realizoi fitim në vlerë dukshëm më të lartë se sa në periudhën e njëjtë të një viti më parë, si rrjedhojë e rënies më të lartë të shpenzimeve kundrejt të hyrave. Të hyrat e sektorit gjatë këtij tremujori arritën në 11.7 milionë euro, që paraqet një rënie për 2.6 milionë euro krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo rënie erdhi kryesisht si rezultat i zvogëlimit të të hyrave nga interesi për 2.7 milionë euro, duke zbritur në 10.6 milionë euro gjatë TM4 2020 (grafik 32). Të hyrat nga jointerеси u rritën për 0.1 milionë euro gjatë këtij tremujori, duke arritur vlerën në 1.0 milionë euro, që kryesisht reflekton ecurinë e të hyrave nga shërbimet.

Grafik 32. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2021)

Shpenzimet e sektorit shënuan vlerën prej 8.7 milionë euro gjatë TM4 2020, vlerë e cila është për 4.9 milionë euro më e ulët se në tremujorin e njëjtë të vitit

paraprak. Rënia e shpenzimeve kryesisht reflekton uljen e shpenzimeve tjera operative dhe atyre nga jointerеси (provizioneve për humbjet e mundshme nga kreditë).

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave shënoi përmirësim, duke u zvogëluar për 19.5 pikë përqindje krahasuar me periudhën paraprake, duke qëndruar në nivel prej 71.9 përqind në TM4 2020. Kjo do të thotë që për çdo 1 euro të investuar, sektori mikrofinanciar shpenzon rreth 0.719 euro. Rënia më e lartë e shpenzimeve kundrejt të hyrave ka ndikuar në rritje të theksuar të fitimit neto krahasuar me periudhën paraprake, prej 3.0 milionë euro gjatë TM4 2020 (grafik 33).

**Grafik 33. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar**




\*Profiti është anualizuar për tremujorin përkatës  
 Burimi: BQK (2021)

Performanca financiare e sektorit u reflektua edhe në dy indikatorët e profitabilitetit, kthimi në mesataren e aseteve (KMA) dhe kthimi në mesataren e kapitalit (KMK), të cilët shënuan rritje krahasuar me TM4 2019 (grafik 33).

Sa i përket treguesve të cilësisë së portfolios kreditore të institucioneve mikrofinanciare, kreditë jo-performuese vazhduan të qëndrojnë në nivel të ulët dhe patën mbulueshmëri të mirë me provizione. Deri

në fund të periudhës, kreditë jo-performuese ishin në nivel prej 3.0 përqind, përderisa mbulueshmëria e KJP-ve me provizione deri në fund të TM4 2020 ishte 142.2 përqind (grafik 34).

**Grafik 34. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore**



Burimi: BQK (2021)

## Tregu i letrave me vlerë


**Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020, Qeveria e Kosovës emtoi borxh në vlerë dukshëm më të lartë se në tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo rritje e nivelit të borxhit sovran reflekton nevojën më të lartë për financim nga Qeveria e Kosovës për shkak të rënies së burimeve të të hyrave dhe rritjes së shpenzimeve, si rezultat i rrethanave të krijuara nga pandemia Covid-19. .**

Borxhi i emtuar nga Qeveria e Kosovës në TM4 2020 shënoi rritje vjetore prej 68.8 përqind krahasuar me TM4 2019, duke arritur vlerën prej 67.5 milionë euro (grafik 35).

Kërkesa për të investuar në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës vazhdon të tejkalojë ofertën, e që ishte për 1.74 herë më e lartë se sa shuma e kërkuar, por që krahasuar me vitin e kaluar, është më e ulët. Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë në TM4 2020

ishte 1.7 përqind, normë kjo më e lartë se në TM4 2019 për 0.2 pikë përqindje (grafik 36).


Grafik 35. Shuma e borxhit të emetuar, rritja vjetore



Burimi: Ministria e Financave (2021)

Rritja e normës së interesit krahasuar me periudhën paraprake reflekton trendin e emetimit të letrave me vlerë drejtë maturimeve afatgjata. Pra, struktura e letrave me vlerë dominohet nga fletë-obligacionet qeveritare, me maturitet prej 3 viteve, pasuar nga ato me maturitet prej 2 viteve.


Grafik 36. Shuma e ofruar dhe emetuar



Burimi: Ministria e Financave (2021)

Vlen të cekët që për të dytin vit me radhë, nuk kemi emetim të bonove të thesarit, maturiteti maksimal i të cilave është 364 ditë (grafik 37).

Grafik 37. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave (2021)

Sektori bankar, fondet pensionale dhe kompanitë e sigurimeve vazhdojnë të jenë institucionet investuese në tregun primar të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës, me ç'rast sektori pensional vazhdon të jetë më i ekspozuari.

**Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:**

BQK (2021): Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiar Nr. 33, TM4 2020, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

**Referencat:**

BQK (2021):

- a) Buletini Mujor Statistikor: [Buletini Mujor Statistikor | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](#)
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: [Seritë Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](#)

ASK (2021):

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: [Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit \(IHÇK\), Shkurt 2021 | \(rks-gov.net\)](#)
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: [Indeksi i Çmimeve të Prodhimit \(IÇP\), TM4 2020 | \(rks-gov.net\)](#)
- c) Indeksi i çmimeve të importit: [Indeksi i Çmimeve të Importit \(IÇIMP\), TM4 2020 | \(rks-gov.net\)](#)
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: [Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë, TM3 2020 | \(rks-gov.net\)](#)
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: [Statistikat e Tregtisë së Jashtme \(STJ\), Janar 2021 | \(rks-gov.net\)](#)
- f) Buletini Tremujor

Të tjera (2020):

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandëve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,46>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://www.fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës; Raporte tremujore: <http://www.trusti.org/sq/per-ne/raporte/835-2/>

Bloomberg (2020): Metal Prices database.

FAO (2018): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2020): Euribor Historical Rates: <http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2020): World Economic Outlook: [World Economic Outlook \(imf.org\)](#)



## Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Dhjetor 2019	Dhjetor 2020
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)*	5,212.7	4,902.3
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	2.7%	0.2%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	1.1%	0.1%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	1,888.2	1,721.2
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	2,070.0	2,205.2
Bilanci primar (në milionë euro)	-181.8	-484.1
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	7,259.9	7,907.8
prej të cilave: Bankat	4,760.5	5,353.1
Kredi	3,031.9	3,246.4
Depozita	3,908.1	4,358.8
Norma e interesit në kredi, fundi i periudhës	6.4%	6.0%
Norma e interesit në depozita, fundi i periudhës	1.6%	1.5%
Hendeku i normës së interesit	4.8%	4.5%
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse	-399.5	-429.4
prej të cilave: remitencat e pranuar	851.7	980.1
Llogaria financiare	-163.0	-502.2
Investimet e huaj direkte në Kosovë	254.6	321.7
Investimet portfolio, net	59.0	-81.6
Investimet tjera, net	-128.8	-195.3
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net*	-304.6	-773.6
Asetet	5,185.2	5,198.6
Detyrimet	5,489.8	5,972.2
Borxhi i jashtëm, gjithsej*	2,160.9	2,381.1
Borxhi i jashtëm privat	1,662.1	1,883.7
Borxhi i jashtëm publik	498.8	497.4

Burimi:

1/ ASK (2020);

2/ MF (2020);

3/ BQK (2020).

\*Të dhënat për PNI dhe borxh të jashtëm janë deri në shtator 2020.

